



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 629, datë 29.7.2020

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE FONDACIONIT “FIRDEUS”, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN
E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr.97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore””, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe fondacionit “FIRDEUS”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kamzë, Mirditë, Lezhë, Kurbin, Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHËTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KËSHILLIT MINISTRAVE

DHE

FONDACIONIT FIRDEUS



PËR

**BASHKËPUNIM NË FUSHËN
E NDËRTIMIT TË BANESAVE PAS FATKEQËSISË**

Sot në datën . . . 2020 lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,

dhe

Fondacioni "FIRDEUS", person juridik i rregjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.576, datë 15.12.2016, ndryshuar me Vendim Gjykate nr. 576/1 të datës 03.10.2018 me NUIS L71627453O, me seli në adresën: "Njësia Administrative nr. 1, Rruga Ali Demi, Nr.25, Kati 1", Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar ligjërisht nga z. Ilir Naçi, i biri i Muharrem dhe Dylbere, lindur më 03.11.1971, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. H11103031L, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar më poshtë si "**Donatori**", të cilëve bashkarisht iu referohet si "**Palët**", dhe secilit prej tyre si "**Pala**"

Duke qenë se:

- A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me Vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "*Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë*", dhe me Vendimin nr.751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "*Për disa shtesa në vendimin nr.750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarku Lezhë*".
- B. Ligji nr.97/2019, "*Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"*, ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta të cilat nëpërmjet donacione, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.
- C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendas ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.
- D. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e "**Projektit**", në funksion të procesit të rindërtimit në territoret e zonave të prekura në bashkitë: Tiranë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë, por kryesisht në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në masën 9 000 000 (nëntë milion) Euro, sipas kërkesave për nevojë të Bashkive përfituese (Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore) si më lart, (referuar në vijim si "**Projekti**"), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Palët, në referim të ligjit nr.97/2019, "*Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"*"; bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

- 1.1 Objekt i kësaj marrëveshje është realizimi i punimeve për ndërtimin e banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat), sipas propozimit të Donatorit dhe bazuar në kërkesës për nevojë të bashkive përfituese (NJVV) Tiranë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.
- 1.2 Në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, Detyrën e Njësisë Zbatuese për mbikqyrje dhe kolaudimin e punimeve për ndërtimin e banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat), sipas propozimit të Donatorit do ta kryejnë Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkia Tiranë, sipas territoreve në të cilën do të zbatohet **“Projekti”**.

Neni 2

Masa e Donacionit

- 2.1 Masa e donacionit sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është në vlerën 9 000 000 (nëntë milion) Euro.
- 2.2 Donacioni sipas kësaj marrëveshjeje do t'i nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

- 3.1 Bashkitë përfituese do t'i garantojnë “Donatorit” një truall të përshtatshëm me sipërfaqe të mjaftueshme, në kuadër të zbatimit të “Projektit”.
- 3.2 Midis Donatorit dhe bashkive përfituese do të lidhet marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit.
- 3.3 Projektet e zbatimit për objektin e marrëveshjes së bashkëpunimit, do të hartohen nga Donatori në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të miratohen nga Palët me konsensus të përbashkët. Zbatimi i projektit do të bëhet nga vet Donatori. Kostoja e ndërtimit të banesave dhe vlera e projektit do të llogaritet duke marrë për bazë projektet e miratuara.
- 3.4 Lejet e nevojshme për zbatimin e “Projektit” do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse në bashkëpunimit me bashkitë përfituese të “Projektit”
- 3.5 Normat e projektimit dhe zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.
- 3.6 Mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve sipas parashikimeve të Ligjit Nr.8402, dt. 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 354, datë 11.5.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” do të realizohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ose Bashkia Tiranë, sipas zonave ku ato janë caktuar si Njësi Zbatuese nga Këshilli i Ministrave dhe vlera e këtyre shërbimeve do të financohet nga programi i rindërtimit.
- 3.7 Kontraktorët, nënkontraktorët dhe konsulentët për realizimin e “Projektit” do të përzgjidhen nga Donatori.

- 3.8 Bashkitë përfituese (NJVV) do të marrin përsipër të garantojnë vendosjen në dispozicion të Donatorit të sheshit të ndërtimit, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e “Projektit”,
- 3.9 Në lidhje me parcelat, truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i shesheve të ndërtimit do të bëhet nga bashkitë përfituese(NJVV). Të gjitha lejet e nevojshme, me qëllim realizimin e këtij “Projektit”, do të sigurohen nga Autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacioni shqiptar, nëpërmjet bashkive përfituese (NJVV).
- 3.10 Të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me palët e treta që gjenden brenda sheshit të ndërtimit (shpronësimi, nxjerrja e njerëzve nga godinat në përdorim, shembja e objekteve, të gjitha përgjegjësitë ligjore ndaj personave që detyrohen të dalin nga sheshi i ndërtimi si pasojë e zbatimit të projektit) i takojnë bashkive përfituese (NJVV) të këtij “Projektit”.
- 3.11 Donatori sipas kësaj marrëveshje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.
- 3.12 Në përfundim të realizimit të projektit, Donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave i cili me Vendim, i kalon objektet e reja në pronësi të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore .
- 3.13 Të gjitha Procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të “Projektit”, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga bashkitë përfituese(NJVV).
- 3.14 Donatori sipas kësaj marrëveshje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Palë dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim dhe do t'i dërgohet dorazi ose me postë rekomande në adresat e mëposhtme:

Fondacioni Firdeus :

Adresa: , Rr. Ramazan Dema, Tirana, Shqipëri

Email: info@firdeus.al

Çdo njoftim ndaj pranuesit të donacionit do të adresohet te:

Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Tiranë,
<https://rindertimi.gov.al/>

Email: Sekretariati.Rindertimi@kryeministria.al

Çdo ndryshim i adresës i njërës Palë do duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5
Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

NENI 7
Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën në lidhje me realizimin e Projektit do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato tek një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

PËR SA MË SIPËR, të nënshkruarit, kanë nënshkruar kontratën në katër (4) origjinalë.

Nënshkruar në Tiranë
më 2020

.....
MINISTRI I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN

Arben AHMETAJ

Nënshkruar në Tiranë
më 2020

.....
DONATORI

FONDACIONI FIRDEUS
Z. ILIR NAÇI

NR.PROT. 3868/1
DATE 3 . 8 . 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKIVE TIRANË, DURRËS, KRUIJË, KURBIN,
KAMËZ, KAVAJË, MIRDITË, VORË, LEZHË,
SHIJAK DHE RROGOZHINË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACTI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Engjell Agacti', is written over a circular official stamp.

